



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:220951

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05637040

KPPP.nr.1667/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “Arbëri Dekor” Sh.P.K., me adresë në fshatin Petrovë, Komuna e Shtimes, me NUI: 810010992, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Kemajl Ademaj me seli të zyrës në Ferizaj, kundër debitorit “Xtremefitness03” Sh.P.K., me adresë në Pejë rruga “Gjeneral Wesley Clark” pn, me NUI: 811299107, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.34/2023 të datës 06.03.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli me seli të zyrës në Ferizaj, jashtë seancës me datë 17.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Xtremefitness03” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.34/2023 të datës 06.03.2023, i nxjerrë nga Përbaruesi Privat Privat Mubarak Shumolli, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.34/2023 të datës 06.03.2023, e ka caktuar përmbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës nr.011A/2022 të datës 26.07.2022, faturës nr.014A/2022 të datës 05.09.2022, faturës nr.017/2022 të datës 04.10.2022, faturës nr.018/2022 të datës 04.10.2022, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 12,470.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e përmbarimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrit të Përmbaresit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se arsyeja kryesore e mos pagesës së këtyre faturave është ngase debitori pas pranimit dhe montimit të lodrave ka vërejtur se shumica prej tyre kanë qenë të dëmtuara dhe të përdorura, për çka debitori është ndarë tejet i zhgënjyer nga ana e kreditorit, dhe në mungesë të komunikimit me kreditorin dhe mos ndërrimin e tyre është bërë edhe kjo neglizhencë e pagesave. I ka propozuar gjykatës që të pranohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbarimor, pasi kreditori nuk e ka plotësuar marrëveshjen në total ashtu siç janë dakorduar palët.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar, dhe si i tillë ka për qëllim vetëm prolongimin-shtyrjen e detyrimit të debitorit për pagesën e borxhit, ngase pretendimet e debitorit mund të kenë ndonjë relevancë në ndonjë procedurë eventuale kontestimore, kurse në procedurë përmbarimore, të njejtat nuk kanë asnjë relevancë. Ka shtuar se prapësimi nuk është i bazuar në asnjë provë, dhe nuk përmban asnjë fakt me të cilin do të dëshmohej se urdhri përmbarimor përmban lëshime të parapara me ndonjërin nga dispozitat ligjore nga neni 71 i LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të lihet në fuqi urdhri mbi lejimin e përmbarimit, si dhe të detyrohet debitori që përpos shpenzimeve të arritura deri në këtë fazë të procedurës, t’ia paguajë edhe shpenzimet për përgjigje në prapësim në shumën prej 208 Euro, sipas TA të OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën nr.011A/2022 të datës 26.07.2022, faturën nr.014A/2022 të datës 05.09.2022, faturën nr.017/2022 të datës 04.10.2022, faturën nr.018/2022 të datës 04.10.2022 në shumën e përgjithshme prej 23,350.00 Euro, nga e cila shumë debitori ka arritur që të bëjë pagesën e pjeshme të borxhit që rrjedh nga faturat e lartcekura, dhe se borxhi i mbetur është në shumën prej 12,470.00 Euro, fakt ky i cili vërtetohet në propozimin për përmbarim nga vet kreditori.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura përmbajnë të gjitha elementet të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37, dhe rrjedhimisht i plotësojnë për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin dhe vulën e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata e vlerësoi pretendimin e debitorit se kreditori nuk e ka plotësuar marrëveshjen në total ashtu siç janë dakorduar palët, mirëpo gjeti se pretendimi i tillë nuk është objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohet në këtë procedurë, ngase kjo

procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 27 dhe 36 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 par.2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbartimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga sa u theksua më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit gjykata ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1667/23, me datë 17.04.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.